



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. "Agim Ramadani", nr.23 ◆ Prishtinë ◆ Kosovë Tel: ++381 38 500 400 0 Fax: + 381 38 248 076 E-mail:
info@pak-ks.org www.pak-ks.org

Agjencia Kosovare e Privatizimit (tani e tutje: "Agjencia"), duke u bazuar në nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), nenin 68, pika 5,6 dhe 7, të Ligjit, nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë, dhe nenin 10.3, të Politikave Operacionale të Agjencisë, publikon:

LISTËN PËRFUNDIMTARE TË PUNËTORËVE

Pasi që asnjë ish punëtorë nuk ka parashtruar kërkesë/ankese për t'u përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve për të përfitur një pjese nga të hyrat e 20%-it nga privatizimi/likuidimi i NSh " Univerzal " (MIT051) Fi 628/89 në Mitrovicë e njëjta shpallet me zero (0) emra.

Çdo punëtor cili mendon se ai/ajo do të duhej të jetë përfshirë në Listën Përfundimtare të Punëtorëve, apo çfarë do pretendimi tjetër ankimor lidhur me publikimin e kësaj liste, mund të parashtrorë ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin prej 20 ditëve nga dita e publikimit të listës në përputhje me dispozitat e theksuara në hyrje të Listës (e nenit 68, pika 5, dhe 7, të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.)

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim dhe të përmbajë: (1) emrin dhe mbiemrin e parashtruesit të ankesës, (2) adresën e parashtruesit/parashtruesve të ankesës dhe (3) faktet ligjore në mbështetje të ankesës. Kopjet e dokumenteve duhet të jenë të vërtetuara nga organi kompetent në përputhje me ligjin.

Në rast se ankesa parashtrohet në emër të ushtruesit të ankesës nga pala e tretë (p.sh avokati), atëherë ai/ajo duhet të prezantojë autorizimin e vërtetuar me shkrim për të ndërmarrë veprime juridike në emrin e tij/saj.

Të gjitha ankesat në lidhje me këtë njoftim duhet të dorëzohen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës deri më datën 09.08.2019 para përfundimit të orarit të punës

Adresa:

**Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës
Pallati i Drejtësisë-Hajvali
10000 Prishtinë, Kosovë**